



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101124/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës.*

Drejtuar : **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Agron HYSI
Drejtor Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës

DURRËS

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës më datë 1.09.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi, z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita me detyrë nd/ komisionerë pranë këtij Mekanizmi.

Objekti kryesor i këtij inspektimi ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Durrës, për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve rekreative me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin në burgje, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit u takua fillimisht me drejtorin e institucionit z. Agron Hysi dhe stafin e tij mbështetës. Nga ana e drejtuesit të këtij institucioni,

grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të kryer vizita në të gjithë ambientet që duhet të monitoronin, si dhe për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me personat e dënuar/ paraburgosur.

Mekanizmi Kombëtar pranë Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Nisur nga informacioni i Drejtorit të institucionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për marrjen e masave për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me dy mjekë, një mjek i përgjithshëm dhe një mjek psikiatër me kohë të plotë.
2. Ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për pajisen e seksionit të kujdesit të veçantë, me mjetet e veçanta të kufizimit fizik dhe me të paktën një shtrat dhe një karrige kufizuese, për shkak të trajtimit mjekësor të personave me probleme të shëndetit mendor.
3. Ishte bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimit për marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Durrës², për ofrimin e kurseve dhe zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional me të dënuarit/paraburgosurit në këtë institucion.

Ndërkohë, një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht:

1. Nuk është kryer hidroizolimi i plotë i tarracës së godinës në regjimin e brendshëm të institucionit, për eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të banimit në të cilat shfaqej herë pas here ky problem.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e organikës me një mjek me kohë të plotë.
3. Institucioni ende nuk ishte pajisur me autoambulancë për përballimin e rasteve të emergjencave për shoqërimin e të sëmurëve në Spitalin Rajonal Durrës apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për rishpërndarjen e të dënuarve në mënyrë proporcionale duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorë të caktuar.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e larmisë të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave.

¹ Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I43-2 prot., datë 18.01.2021.

² Shkresa nr. 198/1 prot., datë 24.08.2021 drejtuar Drejtorisë/Zyrës Rajonale të Formimit Profesional Durrës.

6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi jonë për marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.
7. Nuk ishin marrë masat për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.

Shënime të përgjithshme

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës është kategorizuar si institucion i sigurisë së zakonshme me një seksion siguri të zakonshme, një seksion paraburgimi, si dhe një seksion të veçantë për të dënuar dhe të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor (SKV), me kapacitet fizik për mbajtjen, akomodimin dhe garantimin e kushteve minimale për trajtimin me dinjitet të të dënuarve dhe të paraburgosurve, prej 299 persona të ndarë në 6 sektorë, mesatarisht 14 dhoma për çdo sektor.

Në datën e inspektimit, në këtë institucion vuanin dënimin **318 persona**, nga të cilët 75 persona të dënuar dhe 243 persona të paraburgosur. Institucioni kishte gjithashtu edhe një seksion të kujdesit të veçantë (SKV) ku trajtoheshin 47 persona të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor. Sektori i observimit kishte 8 dhoma, ndërsa sektori i veçimit kishte 3 dhoma. Në ambientin e observimit ndodheshin 56 (pesëdhjetë e gjashtë) persona prej më pak se 14 ditësh secili, ndërsa në dhomat e veçimit nuk ndodhej asnjë person.

Sikurse rezultoi në këtë institucion **kishte mbipopullim** mbi kapacitetin fizik të përcaktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe aktualisht popullimi shfaqej si më poshtë:

- Godina A :

Kati i Parë - 48 të burgosur (kapaciteti 38).

Kati i Dytë, Sektori i Parë - 66 të burgosur (kapaciteti 56).

Kati i Dytë, Sektori i Dytë - 57 të burgosur (kapaciteti 56).

Kati i Tretë, Sektori i Parë (Sektori i të dënuarve)- 39 të burgosur (kapaciteti 42).

Kati i Tretë, Sektori i Dytë - 61 të burgosur (kapaciteti 52).

- Godina B (SKV) :

Kati i Parë - kapaciteti 19 të burgosur (kapaciteti 23).

Kati i Dytë - kapaciteti 28 të burgosur (kapaciteti 33).

Numri i përgjithshëm i të burgosurve gjatë vitit 2021 përkonte si më poshtë:

- Janar 2021 gjithsej 261 persona;
- Shkurt 2021 gjithsej 258 persona;

- Mars 2021 gjithsej 255 persona;
- Prill 2021 gjithsej 259 persona;
- Maj 2021 gjithsej 256 persona;
- Qershor 2021 gjithsej 265 persona;
- Korrik 2021 gjithsej 277 persona;
- Gusht 2021 gjithsej 311 persona;
- Shtator 2021 gjithsej 318 persona.

Është me rëndësi të bëhet ndarja e mësipërme për të sqaruar se vërehet **mbipopullim** kryesisht në muajt e fundit, por ajo që është e rëndësishme është se ky mbipopullim **shoqërohej me fjetjen në tokë** të këtyre personave, duke sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues. Theksojmë se Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018, ka rekomanduar veçanërisht për I.E.V.P. Durrës, se: *“edhe pse numri i përgjithshëm i të dënuarve është ulur krahasuar me vizitat e mëparshme, autoritetet shqiptare duhet të mbajnë në konsideratë mangësinë e përmbushjes së standardit minimal prej 4 m² të hapësirës për person, kur në to sistemohen më shumë persona (në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit që mund të ndodhet brenda dhomës). Standard i cili duhet të respektohet plotësisht në praktikë”*,³ shqetësim ky që është adresuar edhe në rekomandimet tona të mëparshme, bazuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.⁴

Struktura e miratuar e IEVP Durrës, përbëhet nga 181, punonjës prej të cilëve 31 punonjës ishin staf civil dhe 150 ishin punonjës sigurie të shërbimit të policisë. Në organikën e IEVP-së Durrës parashikohen 21 të dënuar/paraburgosur, nga të cilët aktualisht janë të punësuar 14.

Nga informacioni, organika në tërësi ishte e plotësuar, por mungonte një mjek psikiatër me kohë të plotë⁵, ndërsa në organikën e punonjësve të policisë kishte mungesa të 3 punonjësve të rolit bazë (PRB). Pra nga 181 punonjës sipas strukturës së miratuar, aktualisht të punësuar ishin 177 persona dhe në total mungonin 4 punonjës.

³ shih: <https://rm.coe.int/168097986b> “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019) fq. 32.

⁴ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

⁵ Organika e Sektorit të Shëndetësisë është 17 punonjës, nga të cilët :

- 2 Mjekë Psikiatër
- 2 Mjekë të Përgjithshëm
- 1 Mjek Stomatolog
- 1 Kryeinfermier
- 1 Farmacist
- 10 Infermierë

Mbetet shqetësues fakti i mungesës së mjekëve në këtë institucion, çka shkakton shkeljen e drejtpërdrejtë të së drejtës për qasje te mjeku të personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë që interpretuar dhe nga qëndrimet e CPT-së ku parashikohet se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Në vijim të inspektimit, grupi i punës i kushtoi një vëmendje të veçantë masave të marra për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në IEVP Durrës. Në hyrje të këtij institucioni, kryhej procedura për matjen e temperaturës me termometër digjital për të gjithë personelin dhe personat që hynin për takime me të paraburgosurit apo sillnin pako me ushqime dhe veshmbathje sipas nevojave. Gjithashtu, në hyrje ishte vendosur edhe një urë për dezinfektimin e personave që hynin dhe dilnin nga institucioni.

Personeli i institucionit, zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin fizik dhe social, si dhe në mbajtjen e higjienës personale.

Urdhrat, udhëzimet dhe protokollet shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin të afishuar në hyrje të institucionit, zyrat e administratës dhe në hyrje të regjimit të brendshëm.

Ndërkohë që të pyetur për raste të infektimit me Covid-19 dhe masat e marra për vaksinimin, Drejtori i institucionit na bëri me dije se deri më tani janë vaksinuar 130 të dënuar dhe të paraburgosur, çka përbën rreth 41% të popullatës së burgut.⁶

Trajtimi

Gjatë vizitës monitoruese grupi inspektues vizitoi dhe kontaktoi me të burgosurit në të gjitha ambientet e IEVP Durrës, me qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimin të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisioni për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësia e ushqimit, furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjete të higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e këtij institucioni. Sikurse ata pohuan, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit janë të mira dhe korrekte.

⁶ Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve nëpërmjet shkresës me nr. 9593/1 prot., datë 15.09.2021, na ka informuar se deri më tani janë vaksinuar 3047 të burgosur në sistemin penitenciar.

Problematikë shqetësuese mbetet niveli i lartë i lagështirës në disa nga ambientet e banimit dhe kryesisht në ambientet e tualeteve dhe të dusheve të përbashkëta. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit si dhe nga intervistat me të burgosurit, kjo situatë vazhdon të qëndrojë një problem për shkak të mungesës së hidroizolimit të plotë të tarracës së godinave të banimit, por dhe vendndodhjes të institucionit në një zonë të njohur si kënetë. Për shkak dhe të problematikës së përthershme me lagështinë ambienti në tërësi lyhej më shpesh dhe bëheshin riparime të herë pas herëshme.

Dhomat e banimit të dënuarve/paraburgosurve, kishin tualete dhe lavamanë brenda në dhoma. Veç tyre, në çdo sektor kishte ambiente të përbashkëta që shërbenin si tualete dhe dushe për larjen e tyre.

Një shqetësim tjetër ishin **vonesat në kryerjen e vizitave mjekësore**, pasi kishte mungesa në stafin e personelit shëndetësor. Mjeku që kryente detyrën në këtë institucion, nuk ishte me kohë të plotë, por ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme pra 4 (katër) orë në ditë dhe koha për të kryer vizita mjekësore nuk ishte e mjaftueshme, për shkak të numrit të lartë të kërkesave të të dënuarve dhe paraburgosurve që ka institucioni.

Gjithashtu, të intervistuarit ngritën me shqetësim problematikën për karantinën e detyruar, pas çdo dalje nga institucioni, qoftë dhe për vizitë mjekësore te mjekët specialistë në spitalin rajonal Durrës. Kjo, ka kufizuar të drejtën e tyre për të marrë shërbim shëndetësor më të specializuar pranë spitaleve apo klinikave mjekësore, që ndodhen në rajonin e Durrësit.

Në vijim të dënuarit dhe të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve me karakter edukativ dhe social të përbashkët, të cilat nuk u zhvilluan gjatë periudhës së pandemisë, por ato janë përqendruar në këshillime individuale gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë që vijonin rregullisht aktivitetet fetare si dhe zhvilloheshin aktivitetet sportive me të burgosurit në mjediset e ajrimit, por për shkak të pandemisë zhvilloheshin vetëm brenda sektorit. Palestra ishte funksionale dhe në përdorim.

Masat mbrojtëse

Nga intervistimi me të burgosurit dhe me stafin e këtij institucioni, u kërkua informacion në lidhje me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave. Rezultoi se sistemi i kërkesë/ankesave funksionon mbi bazën e urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁷, ku përcaktohen personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike marrin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve, kryejnë regjistrimin në regjistrin përkatës, protokollimin e tyre, si dhe trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit afati të përcaktuar nga titullari i institucionit⁸. Ky regjistër, ruhet dhe administrohet nga sekretaria e institucionit.

⁷ Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

⁸ Neni 58 i ligjit Nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Të paraburgosurit/dënuarit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankesë dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje në një kohë sa më të shpejtë.

Objekti i këtyre kërkesave, sipas informacionit të drejtorit dhe stafit të institucionit, kryesisht konsiston në kërkesa për takim me Drejtorin e Institucionit, takime me familjarët/biseda në SKYPE me familjen, kërkesë për marrje epikrize mjekësore, për zëvendësimin e materialeve të dhomës etj.

Grupi i inspektimit, kërkoi informacion në lidhje me pritjen e të dënuarve/paraburgosurve në institucion, funksionimin e komisionit të pritjes, si dhe me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga intervista me drejtorin dhe stafin e institucionit, u konstatua se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, procedura e ndjekur nga komisioni i pritjes regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej në sekretarinë e institucionit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë një mujore. Problematik ishte fakti se sistemi aktual ishte i amortizuar dhe kishte nevojë për riparime të herë pas hershme.

Theksojmë se mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në IEVP-së, përveç atyre mjediseve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Kushtet materiale

Grupi i inspektimit, në fokus të vizitës së tij pati një interes të veçantë në plotësimin e kushteve materiale që janë në funksion të të dënuarve/paraburgosurve, për

respektimin e standardeve normale të jetesës dhe për zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv.

IEVP Durrës, ndodhet në periferi të qytetit të Durrësit jo shumë larg qendrës, në një vend të populluar dhe lehtësisht të aksesueshëm me mjetet e transportit publik.

Ndërtimi i burgut në një zonë të populluar dhe rrethimi i tij nga ndërtesa civile cenon elementët e sigurisë. Gjithashtu, kjo zonë duke qenë se është një zonë ujëmbajtëse, në ditët kur ka reshje të dendura shiu, pothuajse të gjitha ambientet që ndodhen në katin e parë të burgut përmblyhen duke përhapur lagështirën në gjithë infrastrukturën e regjimit të brendshëm.

Lagështia në disa ambiente, nuk ishte e shkaktuar vetëm nga kënetat që rrethon Institucioni, por edhe nga **mungesa e hidroizolimit të plotë të tarracës**. Lagështia ishte e pranishme në disa prej dhomave të banimit, në ambientin e takimit me familjarët, në kolonën kryesore të tualeteve të dhomave, në ambientet e dusheve të përbashkëta, si dhe në disa nga dhomat e shërbimeve në katin e parë të godinës.

Në IEVP-së Durrës për shkak të mbipopullimit të muajve të fundit **ishin krijuar diferencime** pasi që në disa dhoma banimi ishin shtuar sfungjera ku flinin në tokë të burgosurit. Kjo situatë kishte sjellë për pasojë që numri i personave të akomoduar në dhoma ishte më shumë se norma minimale të hapësirës për person, pasi IEVP Durrës kishte akomoduar persona mbi kapacitetin e parashikuar për të.

Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m² për dhomat për një person dhe 4 m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.⁹ I njëjti standard garantohet dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Dritaret mundësojnë ndriçim natyral të bollshëm. Në dhoma sigurohej energji elektrike për ndriçim dhe nevoja të përditshmërisë. Çdo dhomë banimi kishte tualet më vete. Për shkak dhe të situatës së pandemisë, kishin marrë masat e nevojshme për pajisjen me detergjente për larje, dhe me dezinfektantë e sapunë në mënyrë që të respektoheshin të gjitha protokollet e higjienës.

Ambientet e përbashkëta të dusheve për larjen e trupit ishin funksionale për çdo sektor. Larja e trupit kryhej sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit 2

⁹ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

herë në javë. Theksojmë se, një sektor kishte 14 dhoma dhe një boks të dusheve me 3-4 poste.

Drejtori i IEVP-së na informoi se cilësia e ujit ishte përmirësuar për shkak të dezinfektimit nga Bashkia Durrës, megjithëse nuk kishte arritur standardet e konsumimit si i pijshëm nga të burgosurit.

Institucioni nuk kishte sistem qendror ngrohje/ftohje. Në periudhën e dimrit ngrohja në dhoma realizohej me pajisje elektrike të siguruara nga familjarët e personave të burgosur. Institucioni nga ana e tij kishte bërë dezinfektimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme në mënyrë periodike, madje dhe Bashkia Durrës kishte bërë dezinfektime dhe kishin hapur dhe peseta të reja për përmirësimin e situatës edhe pse ky mbetet një shqetësim për gjithë zonën e kënetës përreth tij.

Spektori i kujdesit të veçantë (SKV), ndodhej si godinë më vete. Godina ishte në gjendje të mirë teknike. Ambienti i tualeteve ndodhej brenda çdo dhome dhe për arsye sigurie dyert kishin një dritare të vogël që lejonte vëzhgimin dhe kontrollin e të burgosurit nga personeli policor. Bojlerët e dusheve të përbashkëta të sektorit të kujdesit të veçantë ndodheshin jashtë këtij ambienti dhe komandoeshin nga personeli i burgut. Kjo zgjidhje, ishte në funksion të elementëve të sigurisë, veçanërisht për personat e burgosur që kanë probleme të shëndetit mendor.

Dhomat e veçimit, ku personat e dënuar shlyenin masat disiplinore, duhet që të plotësojnë të njëjtat kushte dinjitoze për jetesë, ashtu si edhe dhomat e banimit. Ato duhet të jenë të pajisura me krevat, komodina, tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme, të jenë të mirëmbajtura dhe të mundësojnë ndriçim artificial. Këto dhoma ishin të pajisura me orenditë përkatëse.

Kuzhina e institucionit ishte e pastër dhe e rregullt. Ajo funksiononte në kushte normale, pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Personeli i kuzhinierëve ishte pajisur me kartelat shëndetësore. Menyuja javore dhe norma ushqimore ishin të afishuara. Kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike, **por ato nuk ishin të etiketuar** sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, ishin në gjendje të mirë. Në çdo rast edhe këtu mbetet problem kuota ushqimore.

Regjimi dhe aktivitetet

Për shkak të gjendjes së pandemisë ishin ndërprerë aktivitetet nga jashtë, por vazhdonin aktivitetet brenda dhomave si dhe funksiononte normalisht dhoma e ushtrimit fizik. Në këtë institucion ndodheshin disa ambiente që i shërbejnë qëllimit të riintegrit të të burgosurve, si biblioteka, dy dhoma ku ushtrohen rite fetare të besimtarëve mysliman dhe atyre të krishterë, klasa që shërbenin si dhoma për

psikologun etj. Në çdo rast në këtë aspekt ka nevojë për një ndryshim thelbësor në sistem, në mënyrë që këto institucione të krijojnë kushte për rehabilitim efektiv.

Biblioteka ishte një mjedis i vogël i pajisur me televizor, stola dhe një raft jo shumë të pasur me libra. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat.

Vazhdonte e njëjta situatë për sa i përket praktikimit të fesë. Ato ishin të ndara më vetë për besimtarët myslimanë dhe për besimtarët e krishterë. Këto ambiente ishin të lyera dhe të pastra dhe ishin të pajisura me orendi sipas riteve të secilit besim. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin dhe aktivitetet e zhvilluara. Në ambientin e kultit të fesë myslimane nga ora 12:00-13:00, mbledheshin besimtarët dhe praktikonin ritet e tyre fetare. Ndërsa të martën, të enjten dhe të shtunën mbledheshin praktikuesit e fesë ortodokse dhe asaj katolike nën drejtimin e të dërguarave nga kishat respektive të Durrësit, të cilët lejoheshin të vinin fizikisht në ambientet e institucionit duke respektuar masat mbrojtëse të pandemisë. Gjithashtu në ambientin e kultit praktikonin ritet e tyre edhe besimtarët e tjerë protestantë.

Në këtë drejtim, është për tu theksuar se, një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i këtyre personave, i cili do të vlejë në momentin kur ata do të lënë burgun. Ndaj, larmia e aktiviteteve që zhvillohen brenda institucionit duhet të jetë e shumëllojtë, ku në to të përfshihen një masë sa më e madhe e të burgosurve. Për këtë qëllim, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹⁰.

Në IEVP Durrës, konstatoam se, ende mungonin trajnimet profesionale, kjo për shkak edhe të situatës së pandemisë e cila e ka renduar edhe më tej mundësinë e realizimit të tyre. Për këtë arsye, institucioni nëpërmjet shkresës nr. 198/1 prot., datë 24.08.2021, i është drejtuar Drejtorisë/Zyrës Rajonale të Formimit Profesional Durrës për bashkëpunim në fillimin e kurseve profesionale, sipas nevojave dhe kërkesave të të dënuarve. Rreth 60% të të burgosurve kishin shprehur interes për të marrë pjesë në kurse të ndryshme profesionale, ku më së shumti ishin fokusuar në kursin e elektrikistit, hidraulikut, kuzhinierit, gjuhëve të huaja etj.

Në momentin e inspektimit u konstatua se në këtë institucion vuanin dënimin si të paraburgosur 15 shtetas të huaj, me origjinë nga Kosova, Turqia, Maroku, Palestina dhe Kanadaja. Për sa i përket ushqimit, ata trajtoheshin njësoj si të burgosurit me shtetësi shqiptare. Shtetasve të huaj ju ishte krijuar mundësia për të kryer biseda telefonike me familjarët nga ana e institucionit.

¹⁰ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Shërbimi shëndetësor

Organika e stafit mjekësor të IEVP Durrës, është miratuar për 17 punonjës, nga të cilët 2 mjekë psikiatër, 2 mjekë të përgjithshëm (prej të cilëve njëri me kohë të plotë dhe tjetri me kohë të pjesshme), 1 farmacist, 1 mjek stomatolog, 1 kryeinfermier dhe 10 infermierë. Referuar informacionit të marrë nga drejtuesi i institucionit, organika e stafit mjekësor nuk ishte e plotësuar me një mjek psikiatër me kohë të plotë, pasi ky mjek kryente detyrën e tij pranë Spitalit Rajonal dhe paraqiteshe në IEVP Durrës vetëm në rastet kur e kërkonin.

IEVP Durrës, kishte një sektor të kujdesit të veçantë (SKV) të vendosur në një godinë më vete, për trajtimin dhe diagnostikimin e personave të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor. Në momentin e inspektimit në këtë sektor rezultuan të ishin shtruar me rekomandim të mjekut të institucionit 53 persona të dënuar/paraburgosur.

Drejtori i institucionit, ngriti si shqetësim **mungesën e autoambulancës** për të shoqëruar personat e sëmurë në rastet e emergjencave në Spitalin Rajonal Durrës. Deri tani, rastet e emergjencave përballoheshin nga shërbimi spitalor i qytetit të Durrësit.

Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte dhe aktualisht nuk kishin asnjë mungesë në medikamente.

Ndërkohë që organika e personelit mjekësor nuk ishte e plotësuar me 1 mjek psikiatër, i cili zëvendësohej nga një mjek me kohë të pjesshme.

Po ashtu, është për tu theksuar edhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve, e cila shprehet qartë për rolin e drejtuesve të IEVP-ve në plotësimin e kërkesave të personave të burgosur, konkretisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹¹.

Ekziston problemi që personat e dënuar apo paraburgosur të cilët për shkak të mungesës së mjekëve i dërgojnë në spitalin rajonal për mjekim, kur kthehen e kanë të detyruar 14 ditë karantinim në dhomat e veçimit. Kjo çështje përbën problem jo të vogël e për këtë arsye duhet të adresohet që të mos përbëjë shkak që të paraburgosurit/burgosurit të mos kërkojnë të marrin shërbime mjekësore. Gjatë 6 mujorit të fundit ishin kryer rreth 35 teste, nga të cilët kishin rezultuar 4 persona pozitivë me variantin delta, të cilët ishin veçuar menjëherë. Megjithëse nuk kishte pasur humbje jete, propozojmë që të mbahet në vëmendjen e institucionit që është e domosdoshme që të rritet numri i vaksinimit. Duhet të shtohen përpjekjet e

¹¹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

institucionit për rritjen e numrit të vaksinimit duke vendosur postera sensibilizues për vaksinimin e të burgosurve.

Kontaktet me jashtë regjimit

Telefonat me kartë ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm në çdo sektor. Ata ishin në gjendje pune dhe të dënuarit/paraburgosurit e intervistuar, pohuan se flisnin dy herë në javë me të afërmit e tyre nëpërmjet këtyre telefonave.

Sipas informacionit nga drejtuesit e institucionit dhe bazuar në Urdhrin nr. 372, datë 11.6.2021 *“Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”*¹² i ndryshuar, të Ministrit të Drejtësisë, krahas masave lehtësuese, me specifikën që ka sistemi penitenciar, takimet fizike me familjarët do të vijonin të ishin të njëjta, deri në stabilizimin e situatës për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19.

Punësimi

Në momentin e inspektimit, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, nga 21 persona në organikë të punësuar faktikisht ishin të punësuar 14 persona të dënuar/paraburgosur, kryesisht në kuzhinë, pastrim, gjelbërim, shpërndarje ushqimi, bibliotekë dhe magazinë.

Sipas informacionit të drejtuesit të Institucionit, me të paraburgosurit e punësuar nuk ishin lidhur kontrata pune që rregullojnë marrëdhëniet e punës, midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Institucionit të Avokatit të Popullit, në rekomandimet e tij të mëparshme, ka theksuar qartë se, mungesa e lidhjes të kontratës të punës me të dënuarit/paraburgosurit e punësuar është shkelje e një të drejte të sanksionuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kryesisht në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ku përcaktohet se:

*“Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike..... Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen njëjloj edhe për të paraburgosurit e të dënuarit”*¹³.

Së fundmi, me miratimin e Vendimit nr. 602, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*¹⁴, i cili është botuar në F.Z. nr. 161, datë 15.10.2021, pritet edhe zgjidhja e kësaj problematike.

¹² <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2021/06/11/372/79df36b8-05e3-4cc7-a5ad-54ab7a6b9dee>

¹³ Neni 54, Kreu XII, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

¹⁴ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/10/13/602/ba37b99b-6fca-44f7-9936-c3844ff5a837;q=P%C3%8BR%20%20P%C3%8BRCAKTIMIN%20E%20RREGULLAVE%20T%C3%8B%20POSA%20C3%87ME%20P%C3%8BR%20PUN%C3%8BSIMIN%20E%20T%C3%8B%20BURGOSURVE.%20KUSHTET%20E%20PUN%C3%8BS.%20KOH%C3%8BZGJATJEN%20DHE%20SHP%C3%8BRBLIMIN%20E%20SAJ>

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 81, pika 2/b, të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e numrit të përgjithshëm të të burgosurve që vuajnë dënimin në institucionin tuaj, pasi ky **mbipopullim** kryesisht në muajt e fundit është shoqëruar **me fjetjen në tokë** të këtyre personave, gjë që ka sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues të tyre.
2. Marrjen e masave të menjëhershme **për rishpërndarjen e të dënuarve në mënyrë proporcionale** duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorë të caktuar.
3. Marrjen e masave të menjëhershme **për hidroizolim** e **plotë të tarracës së godinës** në regjimin e brendshëm të institucionit, për eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të banimit.
4. Marrjen e masave për **plotësimin e organikës** të stafit mjekësor me një mjek psikiatër dhe një mjek të përgjithshëm me kohë të plotë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për **pajisjen e Institucionit me një autoambulancë** për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Spitalin Rajonal Durrës apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
6. Marrjen e masave të menjëhershme **për zbatimin në kohë** të Vendimit nr. 602, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”, për të zgjidhur një herë e përgjithmonë problematikën e përhershme të rregullimit të marrëdhënieve të punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e larmisë të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.

9. Marrjen e masave të menjëhershme për etiketimin e kampionëve ushqimorë sipas vakteve përkatëse të cilët ruhen në kushte frigoriferike.
10. Marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.
11. Marrjen e masave të mëtejshme për finalizimin e bashkëpunimit me Qendrën e Formimit Profesional Durrës, për ofrimin e kurseve dhe zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional me të dënuarit/paraburgosurit në këtë institucion.
12. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive, në bashkëpunim dhe me organizatat jofitimprurëse duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në këtë institucion.
13. Marrjen e masave për edukimin dhe sensibilizimin e të burgosurve për vaksinim.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

ERMONELA XHAFA

Konc.& Dakord.:

Gloria Çarkaxhiu